

VENDIM
Nr. 787, datë 7.10.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI DHE SISTEMIMI I SHESHEVE BRENDË BLLOQEVE TË BANIMIT, SI DHE KRIJIMI I HAPËSIRAVE REKREATIVE BRENDË TYRE ‘LAGJJA 8 SHKURTI’”, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre ‘Lagjja 8 Shkurti’”, Bashkia Fier.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “trual”, me vlerë 9 559 542 (nëntë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 559 542 (nëntë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekësh, do të përballohet nga fondet e buxhetit të Bashkisë Fier.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, në Bashkinë Fier.
8. Bashkia Fier të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në kontratën e lidhur nga Bashkia Fier me sipërmarrësit e punimeve.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit (Bashkisë Fier).
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit (Bashkisë Fier).

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

**Lista paraprahe e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen pasi preken nga realizimi i projektit:
“Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre
‘Lagjja 8 Shkurti’”.**

Nr .	Emër, Mbiemër	Zona kadastral e	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi Tokë truall/m ²	Vlera totale/lekë	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
					Tokë truall/m ²			
1	Bp. Aristotel Kulari, Llaçi Kulari, Tepi Maqina, Sila Çela, Mina Kulari, Irakli Kulari, Pandeli Kulari, Zoi Kulari, Leonidha Kulari, Urani Kulari, Kalopi Gjika, Jorgjie Kulari, Jona Kulari, Llazar Kulari, Berti Kulari, Imelda Kulari, Harilla Kulari dhe Jani Kulari	8533	3/277	550	550	11,026	6,064,300	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Liman Maloku	8533	3/275	317	317	11,026	3,495,242	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit							9,559,542	